



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:049836
Datë: 11.03.2024
Numri i dokumentit: 05434743

PPP.nr.19/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve, B.S., nga Fshati Zhurë Komuna e Prizrenit, i cili me autorizim në këtë procedurë përfaqësohet nga avokat Hazer Susuri nga Prizreni, kundër debitorit Komuna e Prizrenit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor i Komunës, V.I-Xh., duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, të paraqitur kundër urdhrit Urdhrit për përmbartim P.nr.45/2024 të datës 30.01.2024 të lejuar nga Përmbartuesit privat Mehdi Reshani me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorit, Komuna e Prizrenit, i ushtruar kundër Urdhrit për përmbartim, P.nr.45/2024 të datës 30.01.2024 të Përmbartuesit privat Mehdi Reshani me seli në Prizren, dhe i njëjti Urdhër për përmbartim, LIHET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani nga Prizreni, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit B.S., nga Fshati Zhurë Komuna e Prizrenit, në bazë të dokumentit përmbartimor- akgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.560/2017 i datës 31.10.2022, ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.45/2024 të datës 30.01.2024, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbartimit, duke urdhëruar debitorin, Komuna e Prizrenit, që ta paguaj detyrimin në të holla, në emër të kompensimit të paluajtshmërisë, shumën prej 28,840.00 €, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e parraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës konstatimore në shumën prej 1,681.00 €, dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, në afatin ligjor ka paraqitur prapësim, dhe atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, e me propozim që të refuzohet si i pabazuar

propozimi për përmbardim dhe të anulohet urdhri për përmbardim P.nr.45/2024 i datës 30.01.2024 i përmbarduesit privat Mehdi Reshani nga Prizreni, me tej ka shtuar se, theksuar se kemi paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe propozimi për përmbardim në këtë fazë të procedurës do të shkaktonte dëm material, e me gjerësisht si në arsyetimin e këtij prapësimi.

I autorizuari i kreditorit ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, e duke theksuar se urdhri për lejimin e përmbardimit është i ligjshëm ngase dokumenti përmbardues aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.560/2017 i datës 321.10.2022 është i formës së prerë dhe i përmbardueshëm me datën 18.01.2024, dhe ka skaduar afati për përmbushjen vullnetare të tij nga debitori, i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit në tërësi të refuzohet i pabazë dhe të vërtetohet urdhri i përmbarduesit privat, i ka kërkuar shpenzimet për përpilimin e përgjigjes 250 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe se urdhri përmbardimor duhet të mbetet në fuqi, dhe atë për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbardues ka lejuar përmbardimin bazuar në nenin 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Organi përmbardues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbardimin vetëm në bazë të dokumentit përmbardues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbardimor, përkatësisht aktgjykimin bazë të së cilit përmbarduesi privat ka lejuar përmbardimin dhe gjeti si i njëjti, në kuptim të nenit 22 paragrafit 1, pika 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbardues mbi bazën e të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu, gjykata gjeti se aktvendimi në fjalë i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbardimor është i përshtatshëm për përmbardim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Gjykata vlerëson se aktvendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbardimor i plotëson kushtet sipas nenit 36, paragrafi 1 të LPP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbardim, organit përmbardues i dorëzohet edhe dokumenti përmbardues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbardueshmëris për përmbardueshmëri”*, andaj, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.560/2017 i datës 31.10.2022 është i plotfuqishëm me datën 20.12.2023 dhe i ekzekutueshëm me datën 18.01.2024, me klauzolën e përmbardueshmërisë.

Ndërsa sa i përket pretendimit se debitori ka paraqitur revizion ndaj aktvendimeve të shkallës së parë dhe të dytë, këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi në nenit 213 të Ligjit Procedurës

Kontestimore (LPK-së), thuhet se “*Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarrimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur*”, andaj, gjykata konstaton se revizioni si mjetë i jashtëzakonshëm i goditjes nuk paraqet pengesë për përmbarrimin e aktgjykimit C.nr.560/2017 i datës 31.10.2022, pasi që ky vendim është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, dhe pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarrimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së.

Gjykata rikujton se në këtë procedurë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e rrethanave tjera, me përjashtim të vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së tij, dhe pretendimet e dhëna të debitorit në prapësim, nuk janë pengesë për kryerjen e përmbarrimit.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 3, dhe 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.19/2024

Datë 11.03.2024

Gjyqtari
Sami Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.